



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:275684

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05639595

KA.nr.283/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “BPrAL Kolegji UBT” ShPK me NUI 810514853 dhe seli në lagjen Kalabria p.nr. në Prishtinë, të cilin sipas prokurës e përfaqëson zyra juridike Bardhi&Partners me seli në rrugën Xhemajl Mustafa, hyrja 4, nr. 16 në Prishtinë, kundër të paditurve 1) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me seli në Prishtinë dhe 2) Agjencia e Kosovës për Akreditim me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 17.04.2024 në të cilën morën pjesë përfaqësuesit me prokurë të paditësit dhe të paditurit të dytë, ndërsa i padituri i parë nuk mori pjesë, më 29 prill 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Hedhet poshtë padia e paditësit “BPrAL Kolegji UBT” ShPK me NUI 810514853 kundër të paditurve 1) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe 2) Agjencia e Kosovës për Akreditim me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. ref. 305/19D të datës 25.02.2019 të së padituri të dytë.
- II. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “BPrAL Kolegji UBT” ShPK me NUI 810514853 kundër të paditurve 1) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe 2) Agjencia e Kosovës për Akreditim me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. ref. 1885/190 të datës 01.10.2019 të së padituri të dytë në pjesën që i referohet refuzimit për rikthimin e programit të studimeve “Media dhe Komunikim MA 120 ECTS” dhe tërheqjes së akreditimit për programin e studimeve “Sistem të informacionit MSc 120 ECTS”, detyrimin e të paditurave që të aprovojnë kërkesën e paditësit për akreditim të programeve dhe rikthim të programit të akredituar.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 03.07.2019 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundët të Paditurve me kërkesë për anulimin e vendimit nr. ref. 305/19 D të datës 25.02.2019 të nxjerrë nga i padituri i dytë Agjencia e Kosovës për Akreditim. Këtë kërkesë e kishte ndryshuar përmes parashtresës së datës 07.03.2024, ashtu që e kishte goditur edhe vendimin nr. ref. 1885/190 të datës 01.10.2019 të së padituri të dytë, rrjedhimisht kërkesa e Paditësit ka qenë anulimi i pjesshëm i vendimeve nr. ref. 305/19 D të datës 25.02.2019 dhe nr. ref. 1885/190 të datës 01.10.2019 lidhur me refuzimin e kërkesë për rikthimin të programit të studimeve “Media dhe Komunikim MA 120 ECTS” dhe tërheqjes së akreditimit për programin e studimeve “Sistem të informacionit MSc 120 ECTS”. Me të njëjtën parashtresë kishte deklaruar se e tërheq padinë sa i përket rikthimit të akreditimit për programet e studimeve “Infermeri BSc 180 ECTS (maksimumi 50 student)”, dhe rikthimi i akreditimit për programet e studimeve “Sisteme të informacionit BSc 180 ECTS”.
2. Paditësi në padi ka pretenduar se vendimet nuk janë arsyetuara sipas LPPA-së dhe bien ndesh me parimin e ligjshmërisë të paraparë me LPPA, si dhe nenin 53 të LPPA-së, i cili e rregullon anulimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ. Sipas tij, vendimet bien ndesh edhe me parimin e paanësisë dhe objektiviteti, sepse ai është trajtuar ndryshe nga institucionet tjera të ngjashme. Më tutje ka deklaruar se vendimet e goditura janë në kundërshtim me parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, pasi nuk ka pritur që udhëzimi administrativ 15/2018 do të zbatohet në mënyrë retroaktive, meqenëse të gjitha programet i ishin nënshtruar procesit të monitorimit të plotësisimit të kushteve në bazë akreditimit të vitit 2017, pas të cilit më 18.08.2017 ishte konfirmuar plotësimi i kushteve të akreditimit dhe e drejta e tij për të regjistruar studentë. Gjithashtu ka deklaruar se vendimet bie ndesh me parimin e informimit, pasi nuk ka qenë e informuar paraprakisht mbi klasifikimin e fushave të ngushta për programet e akredituara paraprakisht. Në lidhje me programin e studimeve “Media dhe Komunikacion MA” ka deklaruar se ai ishte akredituar sipas udhëzimit administrativ 2003/2 në vitin 2016, ndërsa akreditimi i është tërhequr duke i zbatuar në mënyrë retroaktive dispozitat e udhëzimit administrativ 2018/15 të miratuar në vitin 2018. Gjatë seancës ka shtuar se është evident fakti se që të dy vendime janë nxjerrë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitën e nenit 100 lidhur me nenin 51 par.1 dhe nenet 98 dhe 99 të LPPA-së, të cilat sanksionojnë

thuktë detyrimin e organit publik për të nxjerrë aktin administrativ sipas kërkesës së palës brenda afateve maksimum 45 ditë, në të kundërtën konsiderohet se kërkesa e parashtruar nga pala vlerësohet si e pranuar në tërësi, ndërsa akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë i pranuar sipas institutit “Akti administrativ i miratuar në heshtje”.

3. I padituri i parë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka paraqitur fare përgjigje në padi dhe nuk ka marrë pjesë në seanca, ndonëse nga gjykata ishte ftuar në mënyrë të rregullt që të jap përgjigje në padi dhe të marrë pjesë në të gjitha seancat e mbajtura.
4. I padituri i dytë e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Sipas tij, vendimet e goditura janë në dhënë duke i respektuar të gjitha dispozitat material dhe procedurale. Ai ka sqaruar se me vendimin 305/19D i datës 25.02.2019 është nxjerrë pasi AKA kishte konstatuar se Paditësi i kishte shkelur kushtet e akreditimit për programet e caktuara të studimeve, ndërsa më pastaj i ka dhënë mundësi të gjithë IAL-ve që t'i kthejnë programet e studimeve, nëse i rikthejnë kushtet e akreditimit. Më tutje ka shtuar se ai përmes vendimit 1885/19D të datës 01.10.2019 i kishte kthyer Paditësit dy programe të studimeve, për të cilat me vendimin e parë ia kishte tërhequr akreditim. Ai ka theksuar se Paditësi ka qenë i informuar për të gjithë procesin dhe është trajtuar në mënyrë të barabartë me të gjithë IAL-të tjerë, sidomos duke e marrë parasysh se ndër vite ka akredituar programe të studimeve për Paditësin. Sipas tij, Këshilli Shtetëror i Cilësisë në bazë të ligjit përkatës për arsimin e lartë e ka për obligim t'i zbatoj standardet evropiane të cilësisë në arsimin e lartë, të cilat ndryshojnë me kalimin e kohës. Përfundimisht e ka vlerësuar padinë e Paditësit si pasafatshme, meqenëse Paditësi vendimin 1885/19D të datës 01.10.2019 e ka pranuar në tetor të vitit 2019.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, meqenëse Paditësi nuk kishte propozuar administrimin e asnjë prove, në seancën për shqyrtimin kryesor u lexuan vetëm shkresat e lëndës në procedurën administrative të cilat i padituri i ka dorëzuar së bashku me përgjigjen në padi, si dhe kopja e librit të protokollit për periudhën kohore nga data 30.09.2019 deri 01.10.2019.

6. Nga komunikimi me e-mail i datës 01.08.2018 rezulton se i padituri i dytë i kishte njoftuar të gjithë institucionet e arsimit të lartë (këtu e tutje IAL) se në bazë të nenit 26 para. 5.3.4 të udhëzimit administrativ nr.09/2017 të datës 02.08.2017 do ta bëjë verifikimin e angazhimit të stafit akademik për programet e studimeve të akredituara për të gjithë IAL-të.
7. Pas kësaj, më 25.02.2019 i padituri i dytë e kishte nxjerr vendimin 305/19D, me të cilin Paditësit i ishte hequr akreditimi për programet e studimit “Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren)”, “Infermieri, BSc, 180 ECTS”, “Media dhe Komunikim, Ma, 120 ECTS”, “Shkenca Kompjuterike dhe Inxheneri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren), dhe “Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS”. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
8. Ndaj këtij vendimi Paditësi më 27.03.2019 kishte ushtruar ankesën 506/19H, me të cilën kishte kërkuar që të anulohet tërësisht vendimi 305/19D dhe të mbetën në fuqi akreditimi i programeve të studimeve, për të cilat ishte tërhequr akreditimi me vendimin e goditur me ankesë. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes ankesës të cekur në këtë paragraf.
9. Më 01.04.2019 i padituri i dytë kishte nxjerr vendimin ref. 548/19D me të cilin i kishte njoftuar të gjitha IAL-të se do tua rikthej akreditimin, nëse ato i kthejnë kushtet e akreditimit sa i përket stafit akademik në ato programe të studimeve. Ky fakt rrjedh nga vendimi i cekur.
10. I padituri i dytë përmes e-mailit më 11.05.2023 i kishte njoftuar disa IAL, duke përfshirë këtu Paditësin, se komisioni i ankesave ka dhënë dorëheqje, rrjedhimisht ish-in udhëzuar që të drejtën për ankimim ta shfrytëzojnë sipas legjislacionit në fuqi. Ky fakt rrjedh nga e-maili si sapo cekur.
11. Paditësi më 11.06.2019 e kishte dorëzuar te i padituri i dytë kërkesën nr. 913/19, me të cilën kishte kërkuar që të pajiset me vendimin administrativ të vërtetuar në heshtje. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kërkesës së sapo cekur.
12. Më 20.09.2019 Paditësi kishte dorëzuar te i padituri i dytë kërkesën për rialokim të stafit nr. 1682/19H me qëllim të përmbushjes së kritereve për programet e studimit, në bazë të cilës i padituri i dytë e kishte nxjerrë vendimin nr. 1885/19D të datës 01.10.2019, me të cilin e kishte anuluar pjesërisht vendimin e tij nr. 305/19D të datës 25.02.2019 dhe ia kishte kthyer akreditimin për programet “Infermieri, BSc, 180 ECTS” dhe “Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS”, ndërsa për programin “Media dhe Komunikim, Ma, 120

ECTS” i ishte refuzuar kërkesa. Me të njëjtin vendim i ishte tërhequr akreditimi për programin “Sistemet e Informacionit, MSc, 120 ECTS”. Këtë vendim Padiësi e kishte pranuar më 01.10.2019. Këta fakt gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur, por edhe përmes librit të pranimi të së paditurit të dytë.

13. Meqenëse është ngritur çështja e afatshmërisë së padisë, gjykata gjen se Padiësi padinë e tij e ka dorëzuar me postë në formë rekomande me numër R-7490483 më 03.07.2019. Edhe pse në vulën e pranimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë figuron data 04.07.2021, megjithatë nga shkresat tjera të lëndës rrjedh se viti i shënuar në vulën e gjykatës është gabim. Kështu, lënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë e kishte numrin A.nr.1589/19, Padiësi e ka paguar taksën gjyqësore më 18.07.2019 me të njëjtin numër të lëndës, sipas vërejtjes së datës 09.07.2019 të gjykatës. Krejt këto tregojnë se Padiësi padinë e kishte paraqitur më 03.07.2019 në zyrën e postës.

III. Vlerësimi meritor i rastit

14. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Padiësit me të cilën është goditur vendimi nr. 305/19D i datës 25.02.2019 i të paditurit të dytë dhe gjeti se ajo është e palejueshme.
15. Neni 13 i LKA-së e ka rregulluar se cili akt administrativ i procedurës administrative mund të goditet me padi. Kështu, në para. 1 të nenit 13 të LKA-së parashihet se “*Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë*”, ndërsa para. 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se “*Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*”. Sipas këtyre dispozitave juridike, vetëm akti administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallën e dytë të procedurës administrative mund të jetë objekt për shqyrtimin e ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa akti administrativ i shkallës së parë përjashtimisht mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ vetëm nëse ndaj tij nuk lejohet ankesa.
16. Në rastin konkret, vendimi nr. 305/19D i datës 25.02.2019 i të paditurit të dytë është akt administrativ i shkallës së parë dhe ndaj tij ka qenë e lejuar ankesa, e madje është ushtruar ankesë në procedurë administrative, siç është sqaruar më lartë. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.4 të LKA-së, sipas të cilit “*Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) 1.4. kundër aktit administrativ, i cili*

kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;”.

17. Gjykata e sheh të arsyeshme të sqaroj që, fakti se i padituri i dytë nuk i kishte vendosur për ankesën e Paditësi brenda afatit kohor nuk i jep të drejtën Paditësit që ta godas direkt vendimin e shkallës së parë. Në rast të tillë, siç rregullojnë nenet 14, 26 para. 2 nënpara. 1.2 dhe 29 të LKA-së, Paditësi e ka pasur mundësinë që t’i kërkoj gjykatës që ta detyroj të paditurin e dytë që të nxjerrë vendim sipas ankesës, por jo edhe t’i kërkoj gjykatë që direkt ta anuloj aktin e goditur me ankesë.
18. Prandaj, për këtë gjykatë padia e Paditësit me të cilin e ka goditur aktin administrativ të shkallës së parë është e palejueshme, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 dhe 2 të LKA-së, në lidhje me nenin 13 para. 1 dhe 2 të LKA-së e hodhi poshtë padinë, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
19. Lidhur me kërkesëpadinë e Paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. ref. 1885/19D të datës 01.10.2019 të së paditurit të dytë gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të ndërgjyqësve, analizimit të provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, duke i batur rregullat nga neni 322 i LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar.
20. Meqenëse objekt i shqyrtimit ka qenë ligjshmëria e vendimit ref. 1885/19D të datës 01.10.2019 në pjesën për refuzimin e kthimit të akreditimit për programin “Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS” dhe tërheqjes së akreditimit për programin e studimeve “Sistemet e Informacionit, MSc, 120 ECTS”, atëherë gjykata do të jap arsyetim vetëm për këtë pjesë të vendimit të goditur. Siç rrjedh nga vendimi nr. 305/19D i datës 25.02.2019, i padituri i dytë i kishte revokuar Paditësit programin “Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS” duke u bazuar në mungesë të stafit akademik të përshtatshëm, sipas nenit 26 pika 5.3.4 e udhëzimit administrativ 15/2018 të datës 28.09.2018. Gjegjësisht, i padituri i dytë kishte konstatuar se anëtari i stafit akademik B.B. është PhD i shkencave politike, ndërsa Artan Mustafa është PhD në filozofi, të cilët sipas të paditurit të dytë nuk i përkasin fushës së programit të studimit. Në këtë frymë, i padituri i dytë kishte vendosur që të veproj edhe kur ka vendosur me pikën II. me vendimin ref. 1885/19D të datës 01.10.2019, me të cilin e kishte refuzuar kërkesën për kthimin programit në fjalë të studimeve.

21. Paditësi me asnjë provë nuk ka arritur ta vërtetojë se dy anëtarët e lartcekur, ose ndonjë anëtar i tjetër i stafit akademik i kishte plotësuar kushtet për të qenë nga fusha përkatëse e programit të studimit. Në këtë drejtim gjykata rikujton se sipas nenit 322 para. 2 të LPK-së *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, ndërsa para. 1 e të njëjtit nen ka paraparë se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*. Pra, Paditësi e ka pasur për obligim që të propozoj administrim të provave me qëllim që vërtetohet se dy personat e cekur më lartë ose ndonjë person tjetër i ka plotësuar kushtet e kërkuara me udhëzimin administrativ përkatës. Gjykata pas analizimit të provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, nuk arriti të vij në përfundim se Paditësi e ka provuar se në momentin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar i kishte plotësuar kushtet në raport me stafin akademik, ndonëse e ka pasur për detyrë që të provoj se kishte staf adekuat për programin në fjalë.
22. Siç rrjedh nga arsyetimi i vendimit ref. 1885/19D të datës 01.10.2019, tërheqja e akreditimit për programin *“Sisteme të Informacionit MSc 120 ECTS”* ishte bërë në bazë të kërkesës nr. 1879/19H të datës 30.09.2019. Nga vendimi i goditur nuk rrjedh qartë se kush e ka paraqitur kërkesën nr. 1879/19H të datës 30.09.2019, por as Paditësi nuk ka sjellë prova që provojnë se tërheqja e akreditimit ka qenë e kundërligjshme. Madje, Paditësi as nuk ka ngritur pretendimet në drejtim të kundërligjshmërisë së kësaj pike të vendimit të goditur, por i është referuar pretendimeve të përgjithshme për kundërligjshmërinë e vendimit të kontestuar.
23. Gjykata e gjeti të pabazuar pretendimin e Paditësit se i padituri i dytë i ka zbatuar në mënyrë retroaktive dispozitat e akteve nënligjore, gjegjësisht udhëzimin administrativ 15/2018 të datës 28.09.2018. Siç rrjedh nga neni 34 para. 1 [Dispozitat Shfuqizuese] i udhëzimit administrativ 15/2018 të datës 28.09.2018, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ do të shfuqizohej udhëzimi administrativ 09/2017. Ky i fundit kishte qenë në fuqi nga data 02.08.2017 deri në datën e shfuqizimit. Të dy udhëzimet administrative në nenin 26 para. 5 nënpara. 3 pika 4 e kanë përmbajtjen e njëjtë, pra kërkojnë që IAL-ja për programin e studimit në nivelin bachelor ose master të ketë së paku një staf akademik në marrëdhënie të rregullt pune me titullin PhD ose të barasvlershëm nga fusha e programit të studimeve. Prandaj, për gjykatën referimi në udhëzimin administrativ të gabuar nuk është relevant, përderisa nuk ka dallim në përmbajtje të udhëzimeve

administrative, si dhe nuk ka kushte shtesë të cilat Paditësi nuk i ka pas të njohura. Për më tepër, vet Paditësi ka sqaruar se të gjithë programet në vitin 2017 i ishin nënshtruar një kontrolli në bazë të udhëzimit administrativ 09/2017, në fund të së cilit ai kishte pasur të drejtë të regjistroj studentë.

24. Lidhur me zbatimin e direktivës së BE-së, gjykata gjen se në pjesën hyrëse ose arsyetuese të vendimit ref. 1885/19D të datës 01.10.2019 nuk ka asnjë referencë në ndonjë direktivë të Bashkimit Evropian. Përkundrazi, në hyrje të atij vendimi gjenden vetëm referenca të ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht gjykata gjen se i Padituri nuk e ka mbështetur vendimin e tij në akte normative jashtë legjislationit të zbatueshëm në Kosovë. Meqenëse gjykata e ka hedhur poshtë padinë sa i përket vendimit nr. ref. 305/19D të datës 16.01.2019, atëherë gjykata nuk mund ta trajtoj bazën juridike të tij, pasi ai juridikisht nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në konflikt administrativ.
25. Pretendimin e paditësit për diskriminim gjykata e gjen të pabazuar. Në rend të parë Paditësi pretendimin e tij ka ngritur në mënyrë tejet të përgjithësuar, duke mos sqaruar më qartë se cili veprim i të Paditurve ka qenë diskriminues. Në këtë drejtim, gjykata i vlerësoi si të mjaftueshëm provat e të paditurit të dytë për të provuar se nuk e ka diskriminuar Paditësin, siç kërkon nenit 20 para. 2 i Ligjit 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi lidhur me neni 322 para. 3 i LPK-së. Si prova të tilla gjykata i vlerësoi njoftimin me e-mail të datës 01.08.2018, sipas të cili i padituri i dytë verifikimin e zbatimit të kushteve të akreditimit e kishte bërë ndaj të gjithë IAL-ve, e jo vetëm ndaj të Paditësit, si dhe listës së programeve të akreditimit në emër të Paditësit për periudhën nga vitit 2009 deri 2026, nga e cila rrjedh se i padituri i dytë i ka akredituar Paditësin një numër të madh të programeve të studimeve. Për gjykatën, këto ishin të mjaftueshme për ta vërtetuar qasjen e barabartë të së paditurit të dytë në raport me Paditësin, për derisa nuk kishte pretendime konkrete për veprime ose mosveprime diskriminuese.
26. Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e Paditësit lidhur me shkeljen e parimeve të procedurës administrative dhe gjeti se ato janë të pabazuara. Kështu, siç është sqaruar më lartë, vendimi nr. ref. 1885/19D të datës 01.10.2019 është i bazuar në LAL dhe udhëzimet administrative që dalin nga ai, rrjedhimisht vendimi juridikisht ka qenë i pritshëm në bazë të dispozitave të udhëzimit administrativ 09/2017, përmban arsye të bollshme lidhur me pjesën e goditur, Paditësi para vendimit të goditur ishte informuar dhe ka pasur në qasje në informatat relevante juridike.

27. Përfund gjykata e sheh të nevojshme të sqaroj se vlerësoi të pabazuar edhe pretendimin e Paditësit se ankesa e tij ndaj vendimit ref. 305/19D të datës 25.02.2019 ishte aprovuar në heshtje. Sipas nenit 135 para. 3 të LPPA-së, dispozitat e nenit 100 të LPPA-së nuk gjen zbatim në fazën e procedurës administrative sipas ankesës. Gjykata rikujton se me fiksioni juridik i aprovimit të kërkesës në heshtje rregullohet pikërisht me nenin 100 të LPPA-së, rrjedhimisht juridikisht nuk vlen ai fikSION në raport me mjetin e goditjes.
28. Për arsyet e cekura më lartë gjykata përfundimisht vlerëson se vendimi i goditur është nxjerrë duke i respektuar dispozitat e procedurës administrative, organi administrativ e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale administrative, si dhe i Padituri ka qenë organ kompetent për nxjerrjen e vendimit të tillë, rrjedhimisht nuk ka asnjë arsye ligjore që ai të anulohet, për pasoj e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e Paditësit lidhur me vendimin nr. ref. 1885/19D të datës 01.10.2019 të së paditurit të dytë.
29. Duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 34 dhe 46 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.283/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.